PROGRAMI I TRANSPARENCËS
BASHKIA DEVOLL

Funksionet e Bashkisë Devoll në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike

Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, Bashkia Devoll është përgjegjëse në territorin e juridiksionit të saj për:

Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.
Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.
Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara.
Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.
Ndriçimin e mjediseve publike.
Transportin publik vendor.
Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit.
Shërbimin e dekorit publik.
Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.
Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.
Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.
Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.
Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Përditësuar në datë 16.03.2026